

VENDIM
Nr. 49, datë 26.1.2022

**PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT NGA AGJENCIA E
TRAJTIMIT TË KREDIVE TEK AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE,
TË PASURISË NR. 7/115, ZONA KADASTRALE 8270, TIRANË, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 20, DATË 19.1.2007, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit nga Agjencia e Trajtimit të Kredive tek Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të pasurisë nr. 7/115, zona kadastrale 8270, me sipërfaqe truall 824 (tetëqind e njëzet e katër) m², me sipërfaqe të katit përdhes 314,4 (treqind e katërmbydhjetë presje katër) m² dhe me sipërfaqe bodrumi 72,3 (shtatëdhjetë e dy presje tre) m², sipas formularit, planrilevimit dhe planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për ushtrimin e funksioneve administrative.

2. Agjencia e Trajtimit të Kredive ruan të drejtën e përdorimit të pasurisë, sipas pikës 1, të këtij vendimi, për një periudhë jo më shumë se 3 (tre) muaj, deri në sistemimin e saj në një ambient tjetër të përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë shtetërore, me kushtin që të mos e ndryshojë destinacionin dhe të mos rëndojë pronën me barrë.

3. Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, pas marrjes në dorëzim të pronës, i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pasurisë, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Pika 1, e vendimit nr. 20, datë 19.1.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve në ndërtesën e degës së Tatimeve, Tiranë, nga kjo degë tek Agjencia e Trajtimit të Kredive dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 818, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve’”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia e Trajtimit të Kredive, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

[illegible]

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONAR SHTET

DATE 13/07/2021

QELLIMI Transferim & Regjistrim

VENDNDODHJA

BASHKIA TIRANE

DVASHK/ZVASHK TIRANE JUG

ZONA KADASTRALE 8270

NUMRI PASURISE 7/115

INDEX HARTE TR-T-11

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE TRUALL

SIP. S1 = 887 m2


SIP. Objekt = 353 m2 (Sipas karteles se Pasurise)

NUMRI KATEVE 4 (+1 Kt. Podrum)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

N/X=4575550.66, E/Y=484546.32

N/X=4575550.66, E/Y=484643.69



N/X=4575485.980, E/Y=484546.32

SH 1:500

N/X=4575485.98, E/Y=484643.69

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	V			7/116 dhe 7/365		
2	L			RRUGE		
3	J			7/211		
4	P			RRUGE		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI: Arkel Bello

LICENCA: NR. T.1374 DATE 11.03.2020

KOMPANIA: PF VILSON BELLO

NIPT: M04724801K

NENSHKRIMI / VULA

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI

DVASHK

NENSHKRIMI

KONFIRMOI

PERGJEGJESI/DREJTORI

NENSHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: G

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT: HK

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:


Koordinatat e paraqitura te 4 kendeve jane mbeshtetur ne referencen koordinative shtetore Shqiptare (ELIPSOIDI ETRS 89 , PROJEKSIONI K.RR.GJ.SH. 2010)

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET


EMRI

NENSHKRIMI

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale



ORIENTIMI I KATËT PERDHE NE LIDHJE ME OBJEKTIN
Sh 1:500




Sipërfaqe Totale e katit Perdhe = 332.6 m²
Nga te cilat: Zyrat = 314.4 m²
Shkallet hyrese = 18.2 m²

Porositë :
AUTORITETI I MBIRËQYKES FINANCIARE (AMP)

PUNQISOR BELLO
EMRI: Arkel Bello
LIC. T.1374 ; Dt. 14.03.2020
KOMPANIA: PF WILSON BELLO
NIPIT: M04724801X

Emertimi i Flates
PLANIMETRIA E KATËT PPERDHE
Sh 1:100

Sh 1:200



Architectural floor plan of a house with dimensions in millimeters. The plan shows a rectangular layout with a central corridor and several rooms. Dimensions are provided for overall and internal measurements. Key features include a kitchen (1054x551), a living area (1054x140), a dining area (1054x155), and a bedroom (1054x178). The plan also shows a bathroom (1054x100), a kitchen (1054x100), and a living area (1054x100). The plan is oriented with the entrance at the top.